

ThankYou

MAGAZINE

MES RRESHTASH ADELINA PALI

Adelina Pali sjell mes
eseve dhe poezisë,
reflektim, emocion
dhe fjalën e shkruar

RRËFE HISTORINË TËNDE

Ylber Sefa, sjell një histori
suksesi të ndërtuar
me këmbëngulje,
disiplinë dhe vite sakrifice.

PODCAST ME JONËN LAURENA BRAKO-JUSUFI

Kur fëmija thotë:
Nuk mundem më!
Pas "dembelizmit"
fshihet një vështirësi

EDUKIM FINANCIAR A IA VLEN? ENRIKO CEKO

Vendimi i zgjuar nuk është:
"A mund ta blej këtë shtëpi?"
por është: "A mund ta
përballoj këtë shtëpi edhe
kur jeta nuk shkon sipas
planit?"

EXCLUSIVE

INTERVISTA E MUAJIT

GLEDIS NANO

Pas uniformës,
është gjithmonë NJERIU

Për gjithçka që jeta na mëson. Për njerëzit që na frymëzojnë. Për historitë që ia vlen të tregohen.

Në këtë numër të **ThankYou Magazine** do të gjeni rrëfime personale,
intervista, histori suksesi, mendime, eksperiencia
dhe tema që prekin jetën tonë të përditshme.

Do të njihni njerëz që kanë zgjedhur të flasin hapur për rrugëtimin e tyre, për
vështirësitë që kanë kaluar, për ëndrrat që kanë ndjekur
dhe për momentet që i kanë ndryshuar.

Do të gjeni histori që frymëzojnë, zëra që duhen dëgjuar dhe mesazhe që ia vlen t'i
përcjellim më tej.

Thank You

— M A G A Z I N E —

MIRË SE ERDHËT

Në këtë numër do të lexoni intervistë ekskluzive me z. Gledis Nano, një bisedë përtej uniformës, për karrierën, autoritetin, jetën, sfidat, njerëzit dhe mënyrën se si përvojat e formojnë njeriun.

Laurena Brako Jusufi, Scientific Director dhe Speech-Language Pathologist pranë Dyslexia Centers – Pavlidis Method, flet për fillimin e vitit të ri shkollor, të nxënit dhe sfidat me të cilat përballen fëmijët me disleksi, ADHD dhe vështirësi në të nxënë. Dyslexia Center sjell gjithashtu një risi të re: shërbimin after-school për nxënësit në spektrin e autizmit.

“Ia Vlen” është platforma që po sjell edukimin financiar më pranë shqiptarëve. Një hapësirë ku mund të krahasohen ofertat e bankave shqiptare në sekonda dhe të përdoren falas mjete si llogaritësi i kredive, depozitave, mikrokredive dhe planeve të internetit, në një vend dhe me transparencë.

Ylber Sefa, një nga emrat më të spikatur të çiklizmit shqiptar, Ylber Sefa, sjell një histori suksesi të ndërtuar me këmbëngulje, disiplinë dhe vite sakrifice. Sefa është kampion i shumëfishtë i Shqipërisë në çiklizëm dhe kampion ballkanik, ndërsa ka garuar edhe në skenën ndërkombëtare.

Një numër me njerëz, histori, ide dhe rrëfime që ia vlen të lexohen.

Sepse pas uniformës, është gjithmonë NJERIU

“Në fund të fundit, karriera mund të ndërtohet me kohë, pasuria mund të fitohet dhe pozitat mund të ndryshojnë, por emri dhe vlerat që lëmë pas janë gjurma jonë e vërtetë në kohë.”

“Mund të humbasësh një betejë pa humbur veten, mund të rrëzohesh pa hequr dorë dhe mund të dalësh i dëmtuar nga një përballje, por jo i mposhtur prej saj.”



Çfarë do të thotë për ju autoriteti? Ku mbaron autoriteti dhe fillon respekti?

Gjatë gjithë jetës i jam përmbajtur një parimi, të cilin e kam ndjerë si bashkudhëtar në rrugëtimin tim: autoriteti është i lidhur në mënyrë të natyrshme me atë model që çdokush ndërton në jetë. Ky format njerëzor përfshin brenda dhe përtej detyrës, pra lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me vetë profilin njerëzor.

Në lidhje me pyetjen e dytë, mendoj se ka dy modele autoritetesh: Ai që qëndron në këmbë nëpërmjet frikës, si model i imponuar, dhe tjetri, krejt i pangjashëm me të parin, ai që vendoset nëpërmjet respektit. Unë, në çdo kohë, pavarësisht çdo rrethane, i përkas këtij të fundit, sepse edhe thellë në vetvete kam respektuar çdo autoritet që ngrihet mbi ndikimin pozitiv në jetën e shoqërisë ku bëj pjesë.

EXCLUSIVE
INTERVIEW

Çfarë ju ka mësuar jeta për njerëzit, që nuk mund ta mësonit nga asnjë libër?

Një ndër dilemat e mia të gjithkohshme lidhet me pikëpyetjen që besoj se mund ta kenë edhe shumë të tjerë: janë fatet njerëzore që kanë krijuar librat apo vetë jetët njerëzore janë ndikuar, përgjatë gjithë kohërave, nga modelet që kanë njohur përmes librave?

Herë-herë, në këtë mëdyshje në vetëdijen time fiton epërsi ideja se njeriu është qenia më e përsosur në pafajësinë e tij për të zhvilluar, gabuar, shpërdoruar apo përmirësuar botën rreth tij. Rastet dhe dukuritë që lidhen me njerëzit e çdo epoke, kulture apo shoqërie janë të panumërta dhe kjo ka qenë dhe vijon të jetë një shkollë e vërtetë për mua dhe jo vetëm për mua.

Të rinjtë kërkojnë sukses të shpejtë. Çfarë do t'u thoshit për durimin dhe ndërtimin e një karriere?

Të gjithë kalojmë nëpërmjet një moshe e cila karakterizohet nga ëndrrat, aspiratat dhe vrullet rinore, karakteristika këto që i ndërlidhin dy tipare të rëndësishme, idealizmi dhe atdhedashuria.

Në moshën time, në të cilën përmbledhet një karrierë afro 25-vjeçare, të rinjve të sotëm do t'u thosha se karriera ka vetëm një alternativë për t'u ndërtuar si e tillë: kohën!

E pra, kjo kohë dhe mënyra sesi përballesh me të përcaktojnë drejtimin dhe mënyrën sesi i je qasur modeleve të kohërave rinore. Parë edhe në këtë aspekt, unë i qëndroj fort mendimit se, sido të vijnë sfidat e jetës, tipari i idealizmit dhe atdhedashurisë tek cilido nuk duhet të humbasë apo të tjetërsohet për asnjë çmim, sepse pikërisht aty përcaktohet vija ndarëse: nëse je vazhdim i njeriut që dikur ëndërronte që, me energjinë dhe sinqeritetin e tij, të ndryshonte botën apo, gjatë viteve, ke krijuar dhe rritur një personalitet tjetër, për rrjedhojë një njeri tjetër, i cili në mënyrë intuitive ka shkëllmuar dhe larguar nga skena të parin, atë të cilin jeta dhe profesioni e mirëpritën në këtë arenë të madhe, të vëzhguar nga sytë e të gjithëve.

Çfarë gabimi shihni shpesh tek të rinjtë dhe që do të dëshironit ta shmangnin?

Të rinjtë e kohëve të sotme po jetojnë në një periudhë dhe në një mendësi të re, por, në fakt, edhe përballë një rreziku: atë të lënies ose të moslënies së gjurmës në epokën së cilës i përkasin.

Kjo ka të bëjë me përgjegjësitë e tyre individuale dhe kolektive për të qenë një forcë që do të duhet të adresojë dhe të vazhdojë procesin e nisur nga paraardhësit dhe pararendësit e tyre.

EXCLUSIVE
INTERVIEW

Etja për të ndërtuar një karrierë të shpejtë, e lidhur shpesh me përfitimet materiale dhe financiare, kam frikë se po shndërrohet në një mendësi dominuese për këtë brez.

Në këtë aspekt, unë do t'i këshilloja çdo të riu dhe të reje që të ketë parasysh se duhet t'u përkasë dhe të ndërtojë vlera të qëndrueshme. Sepse, mbi këto vlera, do të ndërtohen siguria, një karrierë e suksesshme dhe, mbi të gjitha, emri që secili prej nesh do të dëshironte të linte si pjesë të mozaikut të profesionit dhe të rrugëtimit që ka zgjedhur të ndjekë.

Në fund të fundit, karriera mund të ndërtohet me kohë, pasuria mund të fitohet dhe pozitat mund të ndryshojnë, por **emri dhe vlerat që lëmë pas janë gjurma jonë e vërtetë në kohë.

Si kanë ndryshuar brezat? Çfarë kujtoni ju nga koha kur ishit student?

Mendoj se ka një ndryshim drastik dhe të dukshëm. Evolucionin në të gjitha fushat dhe ritmi i shpejtë me të cilin përqipemi të kapim përditshmërinë kanë dhënë ndikimin e tyre. Megjithatë, kjo jo gjithmonë ecën në të njëjtin ritëm me nocionin e kohës.

Kjo sepse koha, në thelb, ka mbajtur të njëjtin kurs, ritëm dhe koherencë. Pikërisht këtu mendoj se ka lindur një kontradiktë që i bën gjeneratat të dallueshme nga njëra-tjetra.

Një pjesë e tyre vjen dhe largohet shpejt nga skena sociale dhe politike, ndërsa tjetra qëndron për një kohë të gjatë brenda epokës që shënjon një brez apo një periudhë historike.

Dhe, nëse do të hulumtojmë brenda kësaj epoke, ata do të jenë gjithmonë aty, si pjesë organike e saj.

Në fund të fundit, një brez nuk përcaktohet vetëm nga koha në të cilën jeton, por edhe nga gjurma që lë në të.

A mendoni se disiplina është diçka që lind me njeriun apo që ndërtohet?

Për mua, disiplina ka qenë gjithmonë pjesë e itinerarit të mënyrës se si i kam ndërtuar detyrimet ndaj vetes, familjes dhe profesionit.

Njeriu, nga natyra, lind si një qenie e lirë dhe, më tej, mëson ose jo të disiplinohet. Unë, për fat të mirë, disiplinën e kam mësuar shumë herët, sepse paraardhësit e mi kishin krijuar një traditë në jetën e tyre familjare dhe profesionale, ku disiplina ishte një normë që përcaktonte çdo marrëdhënie dhe, njëkohësisht, udha e duhur për përmbushjen e çdo aspires.

Me kalimin e viteve kam kuptuar se disiplina nuk është kufizim i lirisë, por një mënyrë për t'i dhënë drejtim asaj. Ajo të mëson të respektosh detyrimin, të përballosh përgjegjësinë dhe të qëndrosh i qëndrueshëm edhe atëherë kur rruga bëhet e vështirë.

A mund të ndryshojë një njeri një shoqëri vetëm duke bërë mirë punën e tij çdo ditë?

Edhe pse mund të tingëllojë si diçka patetike në ditët e sotme, unë besoj se një njeri i vetëm mund të ndikojë dhe, në rrethana të caktuara, të ndryshojë një shoqëri, nëse e kryen me përpikëri detyrën dhe misionin e tij.

Historia na jep shembuj të shumtë. Nelson Mandela është një nga shembujt më domethënës të fuqisë së durimit dhe të qëndrueshmërisë në përmbushjen e një misioni.

Rruga e tij drejt suksesit nuk ishte e shpejtë dhe as e lehtë; ajo u ndërtua përmes një procesi të gjatë, në të cilin bindja ndaj një vizioni u shoqërua me disiplinë, maturi dhe këmbëngulje.

Mandela dëshmoi se ndikimi i vërtetë nuk krijohet domosdoshmërisht përmes protagonizmit të menjëhershëm, por përmes aftësisë për të qëndruar i fokusuar te qëllimi dhe për të pritur momentin kur puna e akumuluar ndër vite mund të shndërrohet në rezultat.

Në fund, ai arriti në majë jo vetëm si një lider politik, por si një figurë që ndryshoi rrjedhën e historisë së vendit të tij.

Ky rast është një kujtesë se durimi nuk është pasivitet; është aftësia për të vazhduar të ecësh drejt qëllimit, edhe atëherë kur rezultati nuk duket ende në horizont.

Çfarë vlere mendoni se po humbasim si shoqëri dhe duhet ta rikthejmë?

Gjykoj se sot, më shumë se kurrë, kemi nevojë të rikthejmë dhe të forcojmë marrëdhënien me njeriun, duke mos lejuar që ajo të zëvendësohet nga ftohtësia dhe distanca e ekraneve.

Teknologjia ka transformuar mënyrën se si komunikojmë, por nuk duhet të lejojmë që ajo të zëvendësojë dimensionin njerëzor të marrëdhënieve tona.

Në mënyrë të pavetëdijshme, rrezikojmë të tjetërsojmë vetë hapësirën njerëzore ku jetojmë dhe ndërveprojmë, atë habitat social që, në thelb, na lidh me të tjerët dhe na rikthen te vetvetja.

Sfida e kohës sonë nuk është të refuzojmë teknologjinë, por të ruajmë ekuilibrin, në mënyrë që progresi teknologjik të mbetet në shërbim të njeriut dhe jo të zëvendësojë atë që e bën marrëdhënien njerëzore të pazëvendësueshme.

EXCLUSIVE
INTERVIEW



Zbuloni Evropën me Ne!



MANU TRAVEL

Udhëtime • Pushime • Eksperienca

 Rr. Muhamet Gjollësja, Tiranë
 067 208 6333 | 069 322 7904
 info@manutransel.al



Cili është një moment që ju ka bërë të ndiheni krenar jo për profesionin, por për njeriun që jeni?

Ndoshta momentet që më kanë bërë më shumë krenar si njeri nuk kanë qenë domosdoshmërisht ato kur kam arritur diçka për veten, por ato kur kam kuptuar se një veprim imi ka pasur vlerë për dikë tjetër.

Në një profesion ku përballesh çdo ditë me situata të vështira, me përgjegjësi dhe me vendime që shpesh nuk kanë zgjidhje të lehta, kam mësuar se suksesi nuk matet vetëm me atë që arrin, por edhe me mënyrën se si silllesh gjatë rrugës.

Ka pasur raste kur kam zgjedhur të bëj atë që kam konsideruar të drejtë, edhe kur kjo nuk ka qenë zgjedhja më e lehtë dhe as ajo që më sillte ndonjë përfitim personal.

Pikërisht në këto momente jam ndier më pranë vetes. Sepse, në fund të fundit, profesioni të jep një pozicion, një titull apo një përgjegjësi; ajo që mbetet është karakteri me të cilin e ke ushtruar atë detyrë.

Dhe nëse ka diçka për të cilën dua të jem krenar, është të mund të them se, pavarësisht rrethanave, jam përpjekur të mos humbas njeriun brenda profesionistit.

Nëse do të mund t'i jepnit një këshillë vetes suaj 20-vjeçare, çfarë do t'i thoshit?

Vetes sime 20-vjeçare do t'i thoja të besonte tek njeriu që një ditë do të bëhej: Gledisi 45-vjeçar.

Do t'i thoja të mos tërhiqej, për asnjë arsye apo rrethanë, nga ëndrra për të ecur përkrah pedagogëve dhe kolegëve të tij në një përpjekje të pakompromis kundër krimit dhe në shërbim të një shoqërie më të sigurt, më të drejtë dhe më të lirë.

Do t'i kujtoja se rruga mund të jetë e gjatë, se rezultatet nuk vijnë gjithmonë menjëherë dhe se, në momente të caktuara, do të jetë më e lehtë të heqësh dorë sesa të vazhdosh.

Por pikërisht atëherë duhet të kujtojë nga vjen dhe për çfarë beson. Të mos i harrojë rrënjët familjare, vlerat dhe idealet që e kanë formuar dhe të përpiqet, gjatë gjithë jetës, të jetë një vazhdues i denjë i tyre.

EXCLUSIVE
INTERVIEW

Për mua, kjo nuk ka qenë dhe nuk është thjesht një zgjedhje profesionale. Është një përgjegjësi që e kam ndier thellë brenda vetes dhe një amanet që duhet ruajtur e përcjellë me dinjitet brez pas brezi.

Sepse, në fund, ajo që mbetet nga një njeri nuk është vetëm ajo që ka arritur, por edhe vlerat që ka mbrojtur dhe gjurmët që ka lënë te të tjerët.

Çfarë do të thotë për ju një jetë e suksesshme?

Një jetë e suksesshme nuk matet thjesht me arritjet apo pozicionet e fituara gjatë rrugës. Ajo lidhet me mënyrën se si e ke përmbushur udhëtimin tënd, si në planin njerëzor, ashtu edhe në atë profesional: me sa përgjegjësi, dinjitet, integritet dhe përkushtim ke përballuar çdo etapë të tij.

Mendoj se është pikërisht kalimi i viteve ai që të jep mundësinë ta shohësh jetën me më shumë objektivitet. Me kalimin e kohës, titujt, pozicionet dhe sukseset e momentit humbasin peshën e tyre dhe mbetet vetëm pyetja më e rëndësishme: a ke qenë besnik ndaj parimeve dhe vlerave që ke zgjedhur të udhëheqin jetën tënde?

Vetveten nuk e gënjen dhe as mundet të të gënjejë dot! Dhe pikërisht përballë vetes, në heshtjen e ndërgjegjes, bëhet bilanci i vërtetë i një jete.

Një jetë e suksesshme është ajo që, kur e sheh pas, mund ta pranosh me qetësi se e ke jetuar me dinjitet, me përgjegjësi dhe pa tradhtuar atë që ke besuar.

Cili është një mësim që do të donit ta merrte çdo lexues nga kjo intervistë?

Do të doja që çdo lexues të merrte nga kjo intervistë një bindje të thjeshtë, por të rëndësishme: Jeta nuk është as shaka dhe as një lojë që mund ta sundojmë sipas dëshirës. Ajo është një provë që, përpara se të përpiqemi ta zotërojmë, duhet së pari ta kuptojmë në thellësinë e saj.

Jeta kërkon të njohësh veten, rrethanat, njerëzit dhe kohën në të cilën jeton, të kuptosh mekanizmat e saj dhe të ndërtohet aftësitë që të lejojnë të përballesh me të.

Por edhe kur i ke bërë të gjitha këto, nuk ka garanci se gjithmonë do të dalësh fitimtar. Ka beteja që i fiton dhe të tjera që i humbet. E rëndësishme është që një humbje të mos të kthehet në një mposhtje.

Ndoshta ky është një nga mësimet më të rëndësishme që kam nxjerrë nga rruga ime: mund të humbasësh një betejë pa humbur veten; mund të rrëzohesh pa hequr dorë dhe mund të dalësh i dëmtuar nga një përballje, por jo i mposhtur prej saj.

EXCLUSIVE
INTERVIEW

Fitorja më e madhe është të ruash aftësinë për të vazhduar, për të mësuar nga ajo që ke kaluar dhe për të mos lejuar që vështirësitë të përcaktojnë se kush je.

Thank You Magazine do t'ju kërkonte t'u thonit “faleminderit” tre njerëzve që kanë ndikuar në rrugëtimin tuaj. Kujt do t'ia thoshit?

Në jetën time ka shumë njerëz dhe figura ndaj të cilëve ndihem vërtet mirënjohës. Nëse do të përmendja vetëm tre prej tyre, do të kisha frikë se, pa dashje, do të lija jashtë jo pak të tjerë që kanë pasur një rol të rëndësishëm në rrugëtimin tim.

Mirënjohja, në fund të fundit, nuk mund të matet gjithmonë me numrin e emrave që përmend, por me gjurmën që njerëzit kanë lënë tek ti.

Kjo lidhet edhe me vetë natyrën e profesionit tim. Ka qenë një profesion ku përballja me rrezikun të bëhet rutinë dhe, në momente të caktuara, një fije e hollë dhe pothuajse e padukshme të ndan nga një dramë apo tragjedi e mundshme.

Në rrethana të tilla, kam mësuar të vlerësoj më shumë se kurrë jetën, kolegët, besimin dhe njerëzit që kanë qenë pranë.

Gjatë këtij rrugëtimi kam marrë falënderime dhe mirënjohje, por kam pasur edhe mundësinë t'ua shpreh mirënjohjen time njerëzve të tjerë. Dhe ndoshta kjo është një nga gjërat më të çmuara që të mëson jeta: se mirënjohja nuk është një ndjenjë që duhet vetëm ta marrësh, por edhe një përgjegjësi që duhet ta shprehësh.

Sepse pas çdo detyre, çdo përballjeje dhe çdo suksesi, ka gjithmonë njerëz që kanë dhënë diçka nga vetja për të të ndihmuar të arrish deri aty ku je.

Mendoj se rrugëtimi i një njeriu nuk ndërtohet vetëm nga sukseset e tij. Ndërtohet nga njerëzit që e kanë edukuar, nga ata që e kanë sfiduar, nga ata që i kanë besuar dhe nga ata që kanë qenë pranë tij në momentet më të vështira.

Prandaj, nëse do të duhej ta përmbledhja në një fjali, do të thosha:

Faleminderit atyre që më mësuam të jem njeri, atyre që më mësuam të jem profesionist dhe atyre që më dhanë forcën për të vazhduar rrugën.

EXCLUSIVE
INTERVIEW

Tiranë, më 3 shtator 2026

Intervistoi: Fationa Molla

Mirëmëngjes,

Krahaso ofertat e bankave shqiptare në sekonda

[Ulogarit ofertën tënde →](#)

[Si funksionon](#)

PRODUKTET

Zgjidh çfarë po krahason

Te gjitha ofertat e bankave shqiptare në një vend.



Kredi shtëpie

14 banka - norme fikse + variabël



Kredi personale

Pa kolateral, dën në 5 site



Kredi makine

Te rejs & te penderuna



Depozitë

Norma e state, LEX & EUR



Internet

Plane fiber & satelitor



Blog

Keshilla & lajme financiare

SI FUNKSIONON

3 hapa për të krahasuar

Pa regjistrim, pa pyetje. Ulogarit dhe krahaso në më pak të 30 sekonda.

1

Zgjidh produktin

Kredi shtëpie, personale, makine, mikrokredi, depozite ose Internet — çlartëse që po kërkon.

2

Vendos kushtet

Shuma, kohegjatësia, monedha. Pa fjalë teknike, vetëm fushat që se nevojën.

3


Krahaso ofertat

Shih ofertet reate të të gjitha bankave anash, me normë erietive (NIS), kiste dhe koate totale.



Ka vendime që i marrim çdo ditë, por që mund të ndikojnë në financat tona për vite...

Një shtëpi.
Një makinë.
Një kredi.
Një depozitë.
Një kontratë interneti.



IA VLEN është platforma që synon t'ua bëjë këtë pyetje më të lehtë shqiptarëve.

Ajo sjell në një vend mundësinë për të krahasuar oferta dhe për të llogaritur produkte të ndryshme financiare dhe të tjera, pa pasur nevojë të kërkosht informacion në shumë burime të ndryshme.

Kredi shtëpie, kredi personale, kredi për makinë, mikrokredi, depozita apo plane interneti, investim në prona, gjithçka mund të eksplorohet nga një platformë e vetme.

Të krahasosh përpara se të zgjedhësh

Ideja është e thjeshtë, por e rëndësishme: Mos u mjafto me ofertën e parë që të duket e përshtatshme. **Krahasoje!**

Një kësht më i ulët nuk do të thotë gjithmonë një kosto më e ulët. Një normë interesi më e lartë mund të ndryshojë ndjeshëm rezultatin final të një depozite.

Një kredi që duket e përballueshme çdo muaj mund të ketë një kosto totale që kërkon më shumë vëmendje.

Një hap drejt edukimit financiar

IA VLEN nuk vjen vetëm si një platformë krahasimi. Ajo vjen edhe në një moment kur edukimi financiar po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm.

SHTËPI APO QIRA?

Vendimi që nuk bëhet vetëm me zemër

A ia vlen të blesh një shtëpi apo të vazhdosh me qira?

Është një nga vendimet më të mëdha financiare që marrim në jetë.

Dhe përgjigjja nuk është e njëjtë për të gjithë.

Përpara se të shohim vetëm çmimin e apartamentit apo këstin e kredisë, duhen parë disa pyetje më të rëndësishme: Sa gjatë do të jetojmë aty?

Sa të qëndrueshme janë të ardhurat? Sa do të na kushtojë realisht kredia? Dhe, mbi të gjitha, çfarë ndodh me jetën tonë pasi paguajmë këstin çdo muaj?

Në një bisedë për **Thank You Magazine**, ekonomisti dhe pedagogu Enriko Ceko e sheh vendimin për shtëpinë përtej dëshirës për të pasur një pronë.

Një kredi nuk duhet parë vetëm përmes këstit mujor. Në llogari hyjnë interesat, komisionet, siguracionet, taksat, mirëmbajtja dhe kostot e tjera që shoqërojnë pronësinë.

Po aq e rëndësishme është edhe ajo që mbetet pas pagesës së këstit.

Një shtëpi mund të jetë pronë, por nuk duhet të kthehet në barrë financiare.

Për një familje që mendon të blejë, një nga pyetjet kryesore është nëse mund ta përballojë kredinë edhe në një periudhë kur të ardhurat bien apo jeta sjell shpenzime të paplanifikuara. Për këtë arsye, fondi i emergjencës dhe ruajtja e një rezerve financiare janë po aq të rëndësishme sa parapagimi.

Edhe krahasimi mes qirasë dhe kredisë nuk mund të bëhet vetëm duke thënë:

“Qiraja është 500 euro, ndërsa kësti 600.”

Këto janë vetëm dy shifra. Vendimi kërkon të shihet kostoja e plotë.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron një nga mësimet kryesore të kësaj bisede: nuk duhet të pyesim vetëm “A mund ta blej këtë shtëpi?”, por:

“A mund ta përballoj këtë shtëpi edhe kur jeta nuk shkon sipas planit?”

“Jeta nuk është vetëm bardh e zi... është edhe gri dhe pjesa më e madhe e jetës së secilit prej nesh është gri.”

Në faqet në vijim, Fationa Molla sjell intervistën e plotë me Enriko Cekon, ku flitet për kredinë, qiranë, blerjen e një shtëpie, kursimet, interesat, riskun dhe mënyrën se si duhet të mendojmë për vendimet tona financiare.

SHTËPI APO QIRA? PYETJET QË DUHEN BËRË

A ia vlen të blesh apo të vazhdosh me qira?

Kjo varet nga tre gjëra: (1) sa gjatë do të jetosh aty, (2) sa kushton kredia dhe (3) sa të qëndrueshme janë të ardhurat. Shtëpia nuk blihet vetëm me zemër; blihet me llogari dhe llogaritë bëhen me Excel.

Kur ia vlen të blesh?

Ja vlen të blesh kur ke të ardhura të qëndrueshme, kursime, ke bërë në plan të qëndrosh gjatë në atë banesë dhe kur kësti mujor i kredisë nuk të mbytet financiarisht.

Kur është më mirë qiraja?

Qeraja është e mirë (1) kur je në fillim të karrierës, (2) kur je në lëvizje të shpeshtë dhe (3) kur nuk ke kapital fillestar, përndryshe do të të konsumojë pothuajse të gjithë të ardhurat.

A është shtëpia “investimi më i sigurt”?

Jo domosdoshmërisht. Blerja e shtëpisë është blerja e një aktivi/aseti real, por kjo nuk e bën atë automatikisht investimin më të mirë. Shtëpia mund të rritet në vlerë, por ka mirëmbajtje, taksa, interesa dhe rrezik tregu. Edhe tullat kanë risk!

Çfarë duhet të mendojë një çift i ri?

Një çift i ri duhet të mbajë parasysh jo vetëm: “Sa na pëlqen kjo shtëpi?”, por: “Sa mund të përballojmë këtë shtëpi pa sakrifikuar jetën?”

Qira 500 € apo kredi 600 €?

Për të balancuar këtë duhet të mendojmë se jo domosdoshmërisht duhet të merret kredi. Kësti mujor i kredisë është vetëm një pjesë e kostos së pronës. Interesat, mirëmbajtjet, siguracionet, taksat dhe shpenzime të tjera hyjnë në ekuacion dhe janë pjesë e rëndësishme e tij.

Sa duhet të jetë kësti?

Si rregull praktik konservator, synohet që kësti mujor i një kredie të jetë sa rreth 25–30% e të ardhurave neto mujoreqë duhet të shkojnë për banesën. Mbi 35% fillon të bëhet më e rrezikshme për shumë familje, sidomos për familjet shqiptare.

Me 1,500 € të ardhura mujore?

Një këst rreth 375–450 € është shumë më komod sesa 600 €, sepse kësti mujor 600 € do të ishte 40% e të ardhurave të kësaj page 1500 € (që vetëm një pjesë ë vogël e shqiptarëve e kanë mundësi ta arrijnë këtë pagë)— pra të mos arrijmë në një katastrofë matematikore, edhe pse me 40% të të ardhurave mund të përballohet por kjo kërkon shumë disiplinë, që zakonisht shumica e qytetarëve shqiptarë dhe kryesisht të rinjtë, nuk e kanë.

Po parapagimi?

Sa më i madh parapagimi, aq më e vogël kredia dhe zakonisht aq më i ulët rreziku. Por këshilla ime është që të mos i futësh të tëra kursimet në blerjen e shtëpisë. Të arrish të bësh një shtëpi dhe të mbetesh me llogari bankare zero nuk është stabilitet financiar, bile nuk është stabilitet në përgjithësi dhe tregon se nuk je mirë nga trutë e kokës.

20,000 € kursime: t'i jap të gjitha?

Jo domosdoshmërisht. Këshilloj mbajtjen e një fondi emergjence, idealisht para për disa muaj shpenzime (minimalisht shpenzimet për tre muaj sikur të mbetesh edhe pa punë), dhe duhet të përdorësh pjesën tjetër për parapagim dhe kostot e blerjes.

Çfarë krahasojmë te bankat?

Te bankat nuk duhet që të krahasojmë vetëm se “Sa është interesi?”, por duhetv të informohemi për normën efektive të kredisë/interesit, koston totale të kredisë, komisionet bankare, siguracionet që duhen paguar paraprakisht, penalitetet në rast të moszbatimit të kontratës së kredisë, kushtet e ndryshimit të normave të interest, etj.

Interes fiks apo i ndryshueshëm?

Për një familje që kërkon parashikueshmëri, norma fikse e interesit është një gjë më e sigurt. Norma e ndryshueshme e interesit mund të jetë më e favorshme/më e përshtatshme në disa periudha, por kjo sjell edhe më shumë pasiguri.

Çfarë duhet pyetur banka para nënshkrimit të kontratës së kredisë?

- Sa do të paguaj gjithsej deri në fund?
- Çfarë ndodh nëse rritet interesi?
- Sa janë komisionet?
- Çfarë penaliteti ka shlyerja e parakohshme?
- Çfarë siguracionesh kërkohen?



Gabimi më i madh i shqiptarëve?

Shqiptarët bëjnë llogari “A e përballojnë këstin?” dhe nuk llogarisin se “A e përballojnë jetën pasi paguajnë këstin?”

A është më mirë një shtëpi më e lirë?

Po. Më mirë një shtëpi pak më e vogël dhe një familje financiarisht e qetë, sesa një apartament luksoz dhe çdo muaj një dramë financiare.

Çfarë ndodh nëse bien të ardhurat?

Nëse bien të ardhurat duhet një fond emergjence. Kjo është thelbësore. Idealisht duhet të kesh një rezervë që mbulon të paktën 2 - 3 muaj shpenzime dhe deri në 5 OSE 6 muaj kur ke detyrime afatgjata.

Qiraja blen fleksibilitet; kredia blen pronësi. Por asnjëra nuk duhet të blejë ankth.


Vendimi i zgjuar nuk është: “A mund ta blej këtë shtëpi?” por është: “A mund ta përballoj këtë shtëpi edhe kur jeta nuk shkon sipas planit?” dhe rastet kur jeta nuk shkon sipas planit janë të shpeshta kohët e fundit.

Duhet të kemi parasysh se jeta nuk është vetëm bardh e zi... është edhe gri dhe pjesa më e madhe e jetës së sejcilit ptrej nesh, ndoshta rreth 90% e të tëra viteve të jetës, është ngjyrë gri. E bardha dhe e zeza për 80 – 90 vite jetë janë vetëm 5 – 6 vite pjesa tjetër e jetës është gri dhe më së shumti gri e errët.

*Prof. Asoc. Enriko Ceko
Intervistoi: Fationa Molla*



PODCASTI | PLOTĚ



YLBER SEFA

Kampioni që vazhdon të garojë, edhe kur rruga nuk është e drejtë

Ylber Sefa është një nga emrat më të spikatur të çiklizmit shqiptar, me 19 vite në këtë sport dhe 11 tituj kampion kombëtarë. Në këtë intervistë për "Podcast me Jonën", ai rrëfen rrugëtimin e tij nga fillimet në Shqipëri, largimin drejt Belgjikës dhe përvojën e tij në garat ndërkombëtare.

Përtej medaljeve dhe rezultateve, Sefa flet hapur për vështirësitë që ka përjetuar, mungesën e mbështetjes dhe sfidat e sportistëve shqiptarë, por edhe për disiplinën, sakrificat dhe dashurinë për flamurin kuqez. Një histori për një sportist që, pavarësisht pengesave, zgjodhi të mos heqë dorë nga ëndrra.

JONA: Nëse jeta do të ishte një garë çiklizmi, cilat do të ishin rugët më të vështira në këtë garë?

YLBER SEFA: Ka shumë rrugë të vështira. Në realitet, jeta është shumë e bukur, por janë njerëzit që ta vështirësojnë jetën. Mendoj se kjo është rruga më e vështirë.

JONA: Cila ka qenë sfida më e madhe që ke përjetuar?

YLBER SEFA: Është viti i 19-të që unë ushtroj sportin e çiklizmit dhe sfida më e madhe ka qenë moszgjedhja e drejtësisë në vendin tim. Në Shqipëri nuk ke një vend ku të ankohesh dhe ankesa jote të merret si bazë kur të është bërë një padrejtësi.

JONA: Çfarë padrejtësie të është bërë?

YLBER SEFA: Shumë padrejtësi. Për shembull, mosmarrja e shpërblimeve nga garat që kam bërë. Unë dola kampion Ballkani në vitin 2019 dhe nuk e mora kurrë atë shpërblim.

Kam dalë edhe 11 herë kampion Shqipërie në dy disiplina dhe prapë nuk e kam marrë shpërblimin. Duke kërkuar të drejtën time dhe duke sakrifikuar për sportin e çiklizmit në Shqipëri, jam bërë si "delja e zezë" për federatën.

JONA: Pra, ti nuk lejohet më të garosh në Shqipëri?

YLBER SEFA: Nuk lejohem të garoj më në Shqipëri. Aktualisht garoj në Belgjikë, me një ekip belg dhe kam kontratë me ekipin. Kam sjellë rezultate në Belgjikë që shumë belgë e kanë ëndërr t'i arrijnë. Në qytetin ku jetoj jam shpallur çiklisti më i mirë i vitit 2022–2023 dhe bashkia më ka dhënë titullin "Qytetar Nderi".

JONA: Pra, në Belgjikë je qytetar nderi, ndërsa në Shqipëri nuk të lejohet të garosh.

YLBER SEFA: Këtu jam i dënuar. Jam i dënuar nga sistemi.

Historitë që meritojnë të tregohen



iTECH ACADEMY

@itech_academy.al



**FITO
PROFESIONIN
TËND:
KURSE
PROFESIONALE**



Smart Home



**NDËRTO TË ARDHMEN
TËNDE NË TEKNOLOGJI**



INSTALIME ELEKTRIKE



SMART HOME KNX



PLC & HMI



CCTV & SISTEME ZJARRI



JONA: A të mungon flamuri shqiptar?

YLBER SEFA: Shumë.

JONA: Do të doje të garoje përsëri për Shqipërinë?

YLBER SEFA: Shumë do të doja. Jam aq i gatshëm saqë ndoshta jo vetëm për të dhënë rezultat, por edhe për t'i dhënë brezit të ri bagazhin dhe eksperiencën që kam marrë në Belgjikë.

Dua t'ua jap të rinjve eksperiencën time.

JONA: Çfarë duhet të ndryshojë urgjentisht në çiklizmin shqiptar?

YLBER SEFA: E para është investimi te çiklizmi dhe sporti në përgjithësi. Pastaj organizimi më i shpeshtë i garave.

Këtu bëhen pesë gara në vit. Unë në Belgjikë bëj pesë gara brenda një jave.

Sportisti nuk stërvitet vetëm nga stërvitja; e stërvisin garat. Në garë merr eksperiencë dhe shkon në limitet e tua.

Në shumë gara më ka shkuar pulsi deri në 210 rrahje në minutë. Në stërvitje nuk të shkon kurrë aq lart. Sulmi i kundërshtarit të detyron ta kapësh dhe të shkosh në limit.

JONA: A paguhesh më mirë në Belgjikë?

YLBER SEFA: Mund të them gati pesëfish më mirë se këtu.

JONA: Po të vinte sot një ofertë shumë e madhe në Shqipëri, ku të thoshin: "Eja, rregulloje komplet çiklizmin, nise nga e para", a do ta lije Belgjikën?

YLBER SEFA: Do ta lija.

JONA: Si ike nga Shqipëria drejt Belgjikës? Na kthe pak te ai moment kur more valixhen.

YLBER SEFA: Në vitin 2012, çiklistët dhe trajnerët e Shqipërisë u ngritën në protestë kundër federatës.

Përballë gjithë këtij kaosi, një ditë mora vendimin të ikja diku. Fillimisht mendoja për Italinë, sepse Italia ka një çiklizëm shumë të zhvilluar.

Por rastësisht një ditë më kontaktoi një koleksionist belg. Ai më tha se i duhej uniforma e ekipit kombëtar të Shqipërisë, sepse nuk e kishte në koleksionin e tij.

Unë fillova t'i tregoja për problemet që kishim dhe ai kishte parë postimet e mia në Facebook për protestat dhe problemet e çiklizmit.

Pastaj më tha: "Pse nuk vjen në Belgjikë?"

Unë i thashë se nuk dija ku të shkoja dhe ku të gjeja ekip. Ai më tha: "Ekipin ta gjej unë."

Nuk kaluan as tre ditë dhe më kontaktoi përsëri. Më tha: "Ta kam gjetur ekipin."

KUR FËMIJA THOTË: UNË NUK MUNDEM

Ndonjëherë pas “dembelizmit” fshihet një vështirësi që fëmija nuk di ta shpjegojë.



Një fëmijë ulet të lexojë. E mbaron tekstin, por kur pyetet se çfarë kuptoi, nuk mban mend pothuajse asgjë. Një tjetër nuk përfundon detyrat, shpërqendrohet, harron udhëzimet dhe refuzon të ulet për të studiuar.

Shpesh përgjigjja e të rriturve është e shpejtë: “Është dembel”, “nuk përqendrohet”, “nuk ka dëshirë”, “është i zgjuar, por nuk përpiqet”.

Por çfarë nëse pas kësaj sjelljeje fshihet diçka tjetër? Në një bisedë për Thank You Magazine, Laurena Brako Jusufi, Scientific Director dhe Speech-Language Pathologist pranë Disleksia Center, shpjegon se vështirësitë në të nxënë kërkojnë të shihen përtej notave dhe sjelljes së dukshme.

Një nga pikat e para është leximi. Nëse fëmija nuk e ka automatizuar procesin e leximit, ai mund të harxhojë shumë energji duke deshifruar fjalët dhe të mos ketë më burime të mjaftueshme për të kuptuar tekstin.



Te disleksia, kjo mund të jetë edhe më e theksuar. Por problemi nuk ndalet te leximi. Kur një fëmijë për vite me radhë përballet me dështime, korrigjime dhe krahasime, mund të fillojë të besojë se nuk është i aftë.

“Unë nuk di.” “Unë nuk mundem.” “Jam më i dobëti i klasës.”

Janë fjali që, sipas Jusufit, specialistët i dëgjojnë shpesh.



Prandaj puna me fëmijën nuk nis gjithmonë me një libër. Ndonjëherë nis duke rindërtuar besimin e tij te vetja. Një nga mesazhet kryesore të saj është identifikimi i hershëm.

Vështirësitë e klasës së parë shpesh kalohen me mendimin se “është ende i vogël” dhe “do ta kapë”. Por kur ato vazhdojnë, boshllëqet rriten dhe bashkë me to rritet edhe frustrimi. Ndërhyrja e hershme nuk ndihmon vetëm në progresin akademik. Mund të ndihmojë edhe në ruajtjen e vetëbesimit të fëmijës.

Në familje fillon edhe vetëbesimi. Prindi është ai që i mëson fëmijës të ngrihet pas një rrëzimi, të provojë përsëri dhe të mos e lidhë vlerën e vet me një gabim. Sipas Jusufit, perfeksionizmi i tepruar mund të krijojë presion dhe ankth. Prandaj fëmija nuk ka nevojë gjithmonë të dëgjojë:

“Ti je më i miri.” Ka nevojë të dëgjojë dhe të kuptojë:

“E pashë sa shumë u përpoqe.” Sepse duhet të shpërblehet edhe përpjekja, jo vetëm rezultati.

Një tjetër keqkuptim që duhet sqaruar është ideja se fëmija apo prindi ka bërë diçka gabim.

Jusufi shpjegon se disleksia dhe ADHD/ADD kanë bazë biologjike dhe nuk janë rezultat i mënyrës se si është rritur fëmija. Mbështetja që merr fëmija nga familja, shkolla dhe specialistët mund të bëjë një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si ai përballet me vështirësinë.

ÇFARË TË MBAJ MË MEND?

MOS E QUAJ MENJËHERË “DEMBEL”.

Pas një fëmije që nuk përqendrohet, nuk lexon mirë apo nuk përfundon detyrat, mund të fshihet një vështirësi që kërkon të kuptohet.

SA MË HERËT, AQ MË MIRË.

Identifikimi dhe mbështetja e hershme mund të bëjnë ndryshim në të nxënë, por edhe në vetëbesimin e fëmijës.

VLERËSO PËRPJEKJEN, JO VETËM REZULTATIN.

Një fëmijë mund të ketë bërë një përpjekje të jashtëzakonshme edhe kur rezultati nuk është perfekt.

NJË FËMIJË NUK ËSHTË NOTA E TIJ.

Vështirësitë në shkollë nuk duhet të kthehen në një bindje se “nuk jam i aftë”.

PËRPARA SE TA KRITIKOJMË, DUHET TË PYESIM: “ÇFARË PO TË PENGON?”

Sepse ndonjëherë pas fjalëve “Unë nuk mundem”, fshihet thjesht një fëmijë që ka nevojë që dikush ta kuptojë.





Dhe kjo vlen edhe për të rriturit. Në Disleksia Center trajtohen jo vetëm fëmijët, por edhe persona të rritur që gjatë gjithë jetës kanë pyetur veten pse lexojnë, shkruajnë, përqendrohen apo organizohen ndryshe.

Ndoshta ky është mesazhi që duhet të mbetet pas kësaj bisede. Një fëmijë mund të ketë vështirësi në lexim dhe të jetë shumë i aftë në fusha të tjera.

Mund të ketë vështirësi në përqendrim dhe të ketë një botë të pasur idesh. Mund të bëjë gabime dhe përsëri të jetë duke bërë një përpjekje të jashtëzakonshme. Prandaj, përpara se ta etiketojmë, duhet ta kuptojmë. Përpara se ta kritikojmë, duhet të pyesim. Dhe përpara se t'i themi “nuk po përpiqesh”, ndoshta duhet të pyesim:

“Çfarë të pengon?”

Sepse ndonjëherë një fëmijë nuk ka nevojë për më shumë presion. Ka nevojë që dikush të kuptojë pse po e ka kaq të vështirë.

E KUQJA

nga Adelina Pali

*E kuqja më veshi, përpara
se ta zgjidhja unë.
M'u ngjit në shpirt si aroma
e një trëndafili të sapoçelur.
Ka shijen e verës së pirë në
gotën e vetmisë.
Ka aromën e puthjes
mbetur ngjizur mbi buzë të
kujtesës.
Dashuria u bë gjaku im.
Çdo rrahje zemre shqipton
emrin e saj.
Ndaj, vishem me të kuqe,
sepse lulet e dhimbjes,
këtë ngjyrë kanë...
Kam zgjedhur t'i dua
gjër n'vuajtjen e mbramë...*



Autore, publiciste dhe poete, ajo e ka ndërtuar rrugëtimin e saj mes jetës, largimit, rikthimit, artit dhe fjalës së shkruar. E lindur në Tiranë dhe e diplomuar në Gjuhë-Letërsi në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Pali e nisi rrugëtimin profesional si mësuese. Në vitin 2005 u largua nga Shqipëria dhe u vendos në Kretë, ndërsa në vitin 2018 u rikthye në vendlindje, së bashku me familjen. Ishte ky rikthim që do t'i hapte sërish rrugë një ëndrrë të lënë pezull: shkrimit.

Në vitin 2021 botoi librin e saj të parë me poezi, “Pa Ty”. Një vit më pas erdhi “Fole Mirësie”, ndërsa në vitin 2023 botoi “Dehja Ime”. Tre vëllime që dëshmojnë një krijimtari të lidhur fort me emocionin, dashurinë, dhimbjen, kujtesën dhe marrëdhëniet njerëzore.

UNË JAM "ARTISTE"

Në jetën e çdo kujt ka gjithmonë njerëz që përpiqen të na dëmtojnë, gjë që kjo është një pjesë e pashmangshme, por ajo që ndihmon ta kalojmë këtë është forca e brendshme, e cila na mban të fuqishëm për të vazhduar përpara. Për mua forca është ajo që vjen nga arti.

Unë jam artiste dhe do ta mbroj gjithmonë pasionin dhe aftësinë time për të krijuar, sepse ky është thelbi im dhe ajo që më bën të veçantë. Unë sjell në jetë peizazhe me ngjyra, krijoj me fjalë, me ide, me imagjinatë. Çdo vepër e krijuar është një reflektim i shpirtit tim, dhe asnjë lloj pengese nuk mund ta ndalë këtë proces.

Shpifjet dhe fjalët e liga nuk janë gjë tjetër veçse përpjekje të kota për të na hedhur poshtë. Ata që nuk mund ta kuptojnë dhe vlerësojnë artin, shpesh kërkojnë të ofendojnë dhe ta njollosin punën tonë. Por, është e pamundur që ata të na mposhtin, sepse zemra jonë është e madhe, dhe ajo është ajo që na shtyn të vazhdojmë të krijojmë ..



Artisti është një njeri që e sheh botën ndryshe, që ka një sy të mprehtë për detajet që shumica e njerëzve nuk i vërejnë, dhe kjo është forcë. Ndonjëherë, kritikët e padrejta mund të bëhen të dhimbshme, por ato nuk mund të ndalojnë rrugën tonë. Artisti nuk kërkon miratim nga të gjithë; ai kërkon të ndjejë lirinë e krijimit dhe të shprehë atë që ka brenda. Një zemër e madhe është ajo që na mban të ndezur në përpjekjet tona për të pasur një ndikim. Është një shpirt që nuk lëshohet nga vuajtjet dhe pengesat që paraqiten. Po, mund të shpifin dhe të hedhin baltë, por ne e dimë se ato janë vetëm ngjarje kalimtare që nuk mund të na ndalin.

Ata që do të mund të na shohin ashtu siç jemi dhe të vlerësojnë punën tonë, janë ata që do të mbesin të frymëzuar nga arti dhe nga vetë ne si individë. Si artiste, ndjej një përgjegjësi të madhe ndaj vetes dhe botës. Të krijosh është një akt i fuqishëm, një akt që kërkon ndjeshmëri, kurajë dhe besim. Më shumë se çdo gjë tjetër, arti është një reflektim i zemrës dhe shpirtit tonë, dhe asnjë fjalë e keqe nuk mund të na e marrë këtë. Kështu që, po, mund të shpifni dhe mund të hidhni baltë mbi mua, por nuk do të më mposhtni kurrë, sepse unë kam një zemër të madhe, dhe jam artiste.

BIZNESI JUAJ, OPTIMIZUAR.



BURIME FINANCIARE



STRATEGJI RRITJEJE



PLANIFIKIM FISKAL

ZGJIDHJE EKSPERTE PËR NJË BIZNES TË QËNDRUESHËM.

ekonomistijuaaj.com ↗



UNË VENDOS TË NDRIÇOJ

E pashë botën me zemrën dhe sytë si të një fëmije... po... si një fëmijë që zgjat duart drejt diellit, duke besuar se ngrohtësia e tij ishte për të gjithë njësoj. Fjala ime ishte e ëmbël e butë, sytë e mi të mbushur me mirësi, duart e mia si gjithmonë gati për të ndihmuar.

Zemra ime nuk kurseu, as nuk peshoi se kujt i takonte më shumë e kujt më pak. Sepse dashuria, mendova, është si uji i burimit, rrjedh e shuan etjen e gjithkujt që i afrohet. Por për çdo fjalë të mirë, mora një shigjetë. Për çdo buzëqeshje, një përbuzje. Për çdo dorë të shtrirë, një grusht të fortë. Dhe sërish nuk kuptova pse. A nuk ishte dashuria ajo që duhej të lindte dashuri?

Sa më shumë dashuri e mirësi jepja, aq më shumë shihja fytyra që largoheshin, buzëqeshje të thyera që ktheheshin në përcimim, shpirtra të zi që nuk dinin ta vlerësonin atë dashuri dhe mirësi të singertë.

Thash me vete: si mund të jetë kaq e dhimbshme të jesh njeri i mirë? Si mund të kthehej dashuria në urrejtje. Megjithatë, unë nuk ndalova kurrë. Sepse nuk dija të jetoja ndryshe. Sepse brenda meje, drita nuk mund të shuhej nga errësira e të tjerëve.

Kuptova që: nuk është dashuria që na dobëson, por pritshmëritë tona se ajo do të na kthehet njësoj. Dashuria e vërtetë nuk matet me atë që marrim pas saj.

Ajo është si një dritë që ndriçon edhe kur askush nuk e sheh. Dhe unë vendosa të vazhdoja të ndriçoja, edhe nëse sytë përreth ishin të mbyllur.



KLAUDIA'S AESTHETIC



**ARTI I AVANCUAR
I REZULTATEVE NATYRALE**



KLAUDIA'S AESTHETICS

KUR ESTETIKA KTHEHET NË STANDARD, EKSPERTIZË DHE BRAND

Nga një profesion i lidhur me bukurinë, Klaudia's Aesthetics ka ndërtuar një pozicionim që shkon përtej shërbimit estetik. Në qendër të këtij zhvillimi është Klaudja Gjikalaj Isufaj, Master në Permanent Make-Up, e cila ka investuar në formim ndërkombëtar dhe specializim profesional për të ndërtuar një standard të diferencuar në tregun shqiptar.

Sot, Klaudia's Aesthetics kombinon Permanent Make-Up, estetikën dhe teknologjinë lazer në një ofertë të integruar. Nga Microblading dhe Microshading te pigmentimi i buzëve, trajtimet e lëkurës, heqja e tatuazheve dhe trajtimet lazer, studioja ka zgjeruar vazhdimisht gamën e shërbimeve duke e kthyer eksperiencën e klientit në një pjesë të rëndësishme të brandit.

Sekreti i suksesit të këtij brandi është rritja e tij, si biznes familjar, e Klaudias së bashku me Erald Isufaj, Master Technician i licencuar në fushën e lazerit. Studioja ka zgjeruar kështu aktivitetin përtej PMU, duke ndërtuar një ofertë më të gjerë estetike dhe teknologjike.

Por një nga elementët më interesantë të historisë së Klaudia's Aesthetics është ndërtimi i autoritetit. Trajnimet ndërkombëtare, titulli Master, puna me klientë të njohur dhe prezenca në treg kanë ndihmuar në krijimin e një emri që lidhet jo vetëm me një shërbim, por me një nivel të caktuar profesionalizmi.

Brand-i ka zgjeruar gjithashtu rolin e tij nga ofrues shërbimesh në qendër trajnimit, duke ofruar programe për profesionistë të rinj në fusha të ndryshme të estetikës dhe PMU. Në këtë mënyrë, eksperiencia e ndërtuar ndër vite nuk mbetet vetëm brenda studios, por kthehet edhe në dije që transmetohet te profesionistë të tjerë. Klaudia's Aesthetics është, në thelb, një shembull i mënyrës se si një aftësi profesionale mund të evoluojë në një brand personal, një biznes të specializuar dhe më pas në një ekosistem shërbimesh dhe trajnimesh.

Dhe ndoshta kjo është pjesa më interesante e historisë: në një industri ku shumë biznese konkurrojnë vetëm me pamjen e rezultatit, Klaudia's Aesthetics ka ndërtuar një pjesë të rëndësishme të diferencimit mbi ekspertizën, certifikimet, teknologjinë dhe autoritetin personal.

Klaudia's Aesthetics është, në thelb, një shembull i mënyrës se si një aftësi profesionale mund të evoluojë në një brand personal, një biznes të specializuar dhe më pas në një ekosistem shërbimesh dhe trajnimesh.

ThankYou Magazine

Makineria e marketingut pas brandeve personale
të sipërmarrësve më të famshëm shqiptarë



#RADIMARKETING

BUILDING PERSONAL BRANDS. GROWING BUSINESSES

Në një treg ku çdo biznes kërkon të shesë më shumë, Radimarketing nis nga një pyetje tjetër: Si bëhet sipërmarrësi një emër që njerëzit e njohin, besojnë dhe duan ta ndjekin?

Radimarketing është një kompani marketingu dhe strategjie e fokusuar në ndërtimin e personal brands për sipërmarrësit. Qëllimi nuk është thjesht të krijojë content, por të ndërtojë një sistem që lidh emrin e sipërmarrësit, reputacionin e tij dhe rritjen e biznesit.

Nga strategjia dhe pozicionimi, te temat, storytelling, skriptet, produksioni, editimi dhe shpërndarja, Radimarketing funksionon si një departament i jashtëm marketingu për sipërmarrësit që duan të bëhen më të dukshëm dhe më relevantë në treg.

Ideja është e thjeshtë: një sipërmarrës mund të ketë ndërtuar një biznes të suksesshëm, por nëse tregu nuk e njeh historinë, ekspertizën dhe vizionin e tij, një pjesë e madhe e vlerës së tij mbetet e padukshme.

Radimarketing e kthen këtë eksperiencë në pozicionim, content dhe autoritet.

Kompania punon me sipërmarrës që kanë tashmë një histori për të treguar dhe një biznes për të rritur. Në vend që personal branding të trajtohet si një aktivitet paralel me biznesin, ai ndërtohet si pjesë e strategjisë së tij të rritjes.

Contenti bëhet mjet për të krijuar reputacion.

Reputacioni bëhet mjet për të krijuar besim.

Besimi bëhet avantazh në biznes.

Kjo është arsyeja pse Radimarketing nuk pozicionohet thjesht si një agjenci kreative. Është një marketing dhe makineri strategjie për sipërmarrësit.

Në një ekosistem ku vëmendja është bërë një nga asetet më të rëndësishme të biznesit, Radimarketing synon të ndërtojë sipërmarrës që nuk janë vetëm drejtues të kompanive të tyre, por edhe figura me autoritet brenda tregut që kanë ndërtuar.

Build the Person. Build the Reputation. Grow the Business.



ME JONËN

PODCAST

Je profesionist, ekspert apo ke një eksperiencë që ia vlen të dëgjohet?

Rezervo hapësirën tënde në Podcast me Jonën.

**successmade
in albania**

ThankYou
— M A G A Z I N E —



PODCAST 
by Xhulio Radi




**RADI
MARKETING**

Radi Marketing, Success Made in Albania dhe Albania Success Network janë më shumë se logo apo emra markash. Ato përfaqësojnë një vizion të përbashkët, të promovojnë historitë, idetë dhe njerëzit që krijojnë vlerë.

Përmes podcasteve, komunikimit dhe rrjetëzimit, këto platforma sjellin në vëmendje sipërmarrës, profesionistë dhe histori suksesi shqiptare, duke krijuar hapësira për frymëzim, bashkëpunim dhe mundësi të reja.

Thank You

— M A G A Z I N E —

Na takoni sërish në faqet e ardhshme, me njerëz të tjerë, rrëfime të vërteta dhe histori që meritojnë të tregohen

ÇMIMI 500 LEKË